

2

REPUBLICA KOSOVA AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep: Dip: Dip:	D-P
Nr. Prot: Dip. Prot: Prot. Nr.:	03-4663/11
Nr. Kom: Drejt. Stranica Rr. Kom.:	01
Datë: Drejt. Datë: Datë:	30.11.2011

Nr. regj. 37305/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Irfan(Isak)Lipovica, nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 18.11.2011 morri këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Irfan(Isak)Lipovica, i lindur më 28.11.1985 në Ferizaj, tani me vendbanim në fshatin Dardanë, Komuna e Ferizajt, ka kryer magjistraturën në politikë publike, i pamartuar, i gjendjes së mirë ekonomike, më parë i padënuar,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

1. Sepse pas emërimit në pozitën e U.D të Drejtorit të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të politikave, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarinë e pasurisë me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik, ashtu si parashihet me ligj, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, andaj i shqiptohet

D Ë N I M

Me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Paguesa bëhet në ndonjë agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **26(njëzetegjastë) ditësh**, duke llogaritur për çdo **15 €**, nga **1(një) ditë burgu**.

Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga **10 €**, në afat dhe xhirrollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashitroi kësaj gjykate kërkesën nr. 01-4107/2011 me datë 26.10.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Irfan Lipovicës, për kundërvajtjen nga neni 7 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, Nr 04-/L-050, duke propozuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se posa ka kuptuar nga mediat për këtë, ka deklaruar pasurinë dhe ka prezantuar Vërtetimin nr. 03-4181 të datës 28.10.2011, se tani e ka bërë deklarinë e pasurisë duke cekur se nuk ka ndonjë pasuri. Pozitën e U.D të Drejtorit të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të politikave në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në Prishtinë, e ka marr më datë 15.07.2011.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi të deklaratës së të pandehurit, vlerësimi të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar këtë gjendje faktike: se i pandehuri Irfan Lipovica, si zyrtar i lartë publik në pozitën e U.D të Drejtorit të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të politikave në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në Prishtinë, nuk ka deklaruar pasurinë me marrjen e postit, andaj në masë të mjaftueshme vërtetoi se ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihen në barrë. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, duke pas parasysh se në kohën e kryerjes së kundërvajtjes ka qenë në fuqi Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, Nr. 03/L-151, i cili është më i favorshëm për palën, gjyqtaria aplikoj këtë ligj dhe shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 37305/2011, më datë 18.11.2011

Gjyqtaria

Azra Cakolli

A. Cakolli
KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh. Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.